REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA MALIQ

DREJTORIA E SHËRBIMEVE SOCIALE, ARSIMIT DHE SHËNDETËSISË

Maliq më 18.12.2025

6677

Projekt-Vendim -NR.12

Për "Dhënien e Ndihmës Financiare për familjet në nevojë"

Në mbështetje të ligjit nr .139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore",ligji nr 9936,datë 26.06.2008,"Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë" dhe ligjit 121/2016 , "Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Shqipëri" dhe në bazë të verifikimeve të bëra nga punonjësit e Ndihmës Ekonomike Maliq, të Njësive të Bashkisë Maliq për gjendjen social-ekonomike të familjeve i kërkojmë Këshillit të Bashkisë:

I. Miratim fondi për familjet e mëposhtëme:

Nr.	Emri Mbiemri	ID	Nj.Administrative	Shuma /Lekë
1	**Lulëzime Shkëmbi**	F755171931	Maliq	100 000
2	**Gentian Brahimllari**	H70428040K	Pirg	40 000

II. Fondet do të përballohen nga Buxheti i vitit 2026, si më poshtë :

Gr.	kap	Kod. Prog.	Llog.eko	Emert.Llogarise	Vlera në lekë
00	05	01110	606	Fondi Social	140 000

III. Bashkëngjitur projekt-vendimit relacionin me gjëndjen Social–Ekonomike të familjes.

Konceptoi Pergj.Sek I Sherbimeve Sociale
Miratoi:Dr. Drejtoria e Shërbimeve Sociale, Arsimit dhe Shëndetësisë

(Emër Mbiemër)
J.Hoxha
E.Petriti

Nënshkrimi

KRYETARI I BASHKISË

Gëzim Topçiu

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - BASHKIA MALIQ

Adresa: Bulevardi "Rinia", Maliq, Korçë

Tel. & Fax. 0861 2 2026

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA MALIQ
DREJTORIA E SHËRBIMEVE SOCIALE, ARSIMIT DHE SHËNDETËSISË

Maliq më 1812.2025

6677

Relacion

Për "Dhënien e Ndihmës Financiare për familjet në nevojë"

Në mbështetje të ligjit nr .139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore",ligji nr 9936,datë 26.06.2008,"Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë" dhe ligjit 121/2016 , "Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Shqipëri" dhe në bazë të verifikimeve të bëra nga punonjësit e Ndihmës Ekonomike Maliq, të Njësive të Bashkisë Maliq për gjendjen social-ekonomike të familjeve të mëposhtme rezultoi se:

1.Lulëzime Shkëmbi.

Znj. Lulëzime Shkëmbi është banore e qytetit Maliq, Bashkia Maliq. Ajo jeton së bashku me tre fëmijët e saj, dy djem dhe një vajzë, pasi bashkëshorti i saj ka ndërruar jetë disa vite më parë. Që prej asaj kohe, znj. Shkëmbi është e vetmja mbështetje familjare dhe ekonomike për fëmijët e saj, duke mbajtur mbi supe të gjithë barrën e përkujdesjes dhe sigurimit të të ardhurave.Znj. Lulëzime ka rritur e vetme fëmijët e saj në kushte të vështira sociale dhe ekonomike.Djali i madh, Ariald Shkëmbi që prej vitit 1997 trajtohet me pagesën e aftësisë së kufizuar (Prapambetje Mendore e Thellë, me kujdestar). Gjendja e tij shëndetësore kërkon përkujdesje të vazhdueshme, mbikëqyrje dhe shpenzime të konsiderueshme, si në aspektin mjekësor ashtu edhe në atë social.Gjatë kohëve të fundit, edhe Redilian Shkëmbi ka shfaqur probleme të shëndetit mendor, duke pasur disa episode që kanë kërkuar trajtim dhe ndjekje të specializuar. Për këtë arsye, ai është dërguar për kurim në Spitalin Psikiatrik "Shën Kolli" në Lezhë, çka ka sjellë vështirësi të shtuara emocionale dhe financiare për familjen.Për shkak të këtyre problematikave shëndetësore dhe sociale, familja Shkëmbi ndodhet në një gjendje të theksuar vështirësie ekonomike. Të ardhurat e vetme të familjes janë pagesa e KEMP-it që përfiton djali Ariald, e cila është e pamjaftueshme për të përballuar nevojat bazë të jetesës, shpenzimet ushqimore, mjekësore dhe shërbimet e tjera të domosdoshme.Znj. Lulëzime Shkëmbi ndodhet në kushte të vështira sociale dhe financiare, duke u përballur çdo ditë me vështirësi të mëdha për sigurimin e një jete dinjitoze për veten dhe fëmijët e saj.

2. Gentian Brahimllari.

Z. Gentian Brahimllari është banor i fshatit Zvirinë, Njësia Administrative Pirg, Bashkia Maliq. Ai është kryefamiljar i një familje që jeton në kushte të vështira socio-ekonomike.Familja përbëhet nga 5 anëtarë Gentiani ,bashkëshortja ,dy fëmijët e mitur dhe nga nëna e tij, e cila është në moshë të thyer. Banesa ku familja jetonte ishte tepër e vjetër dhe e amortizuar.Si pasojë e reshjeve të dendura të shiut në datat 20.11.2025 – 21.11.2025, rreth 50% e ndërtesës u shemb,

ndërsa pjesa tjetër mbetet në rrezik të menjëhershëm shembjeje, duke e bërë të pamundur dhe të rrezikshëm qëndrimin në të.Familja e Z. Gentian Brahimllarit ndodhej prej kohësh në gjendje varfërie ekstreme dhe përfitonte vetëm ndihmë ekonomike në vlerën 6,181 (gjashtë mijë e njëqind e tetëdhjetë e një) lekë në muaj, pa asnjë burim tjetër të ardhurash.Aktualisht, familja ka mbetur pa strehë dhe përfshin dy fëmijë të mitur, bashkëshorten, si dhe nënën e tij të moshuar dhe të sëmurë. Për shkak të pamundësisë financiare për të përballuar koston e një banese me qira, kërkohet nga Këshilli i Bashkisë akordimi i një ndihme financiare për mbulimin e shpenzimeve të qirasë për një periudhë minimale 6 (gjashtë) mujore, deri në gjetjen e një zgjidhjeje për rikonstruksionin e banesës së dëmtuar.

Konceptoi Pergj.Sek I Sherbimeve Sociale J.Hoxha
Miratoi:Dr. Drejtoria e Shërbimeve Sociale, Arsimit dhe Shëndetësisë E.Petriti

KRYETARI I BASHKISË
Gëzim Topçiu

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA MALIQ